

VENDIM
Nr. 379, datë 31.8.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KURBIN SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”(VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e 567 përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 31.8.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kurbin sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Ujësjellës Kanalizime Kurbin me shkresën nr. 246 prot., datë 15.08.2022, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Kurbin në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Kurbin ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 30 212 banorë të Bashkisë Kurbin për tri njësitë administrative: Laç, Mamurras, Milot.

b) drejtuesi ligjor z. Drilon Aliu është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë.

c) drejtuese teknike znj. Junilda Elezi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Inxhinieri Hidroteknikë në vitin 2007 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kurbin, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Kurbin është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a., me (NUIS K07628310A), në kategoritë:

- a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

- a) drejtues ligjor – Drilon Aliu;
- b) drejtues teknik – Junilda Elezi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a. është Bashkia Kurbin.

Njësitë administrative: Laç

Mamurras

Milot

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani